1830 – BENJAMIN DISRAELI – DY HERË KRYEMINISTËR I BRITANISË SË MADHE VIZITON SHQIPËRINË DHE SHKRUAN

“NALTËSIMIN E ISKANDERIT”

NGA MAL BERISHA

Midis të gjithë udhëtarëve që kanë përshkuar Shqipërinë, njëri prej tyre është ndoshta më interesanti për nga rëndësia historike: Benjamin Disraeli, dy herë Kryeministër i Britanisë së Madhe gjatë epokës së Mbretëreshës Viktoria. Siç e tregon edhe emri i tij, ai njihej si "benjamini" i Mbretëreshës Viktoria. Herën e parë qeverisi për vetëm nëntë muaj, nga shkurti deri në dhjetor të vitit 1868, ndërsa herën e dytë për gjashtë vjet, nga shkurti 1874 deri në prill 1880.

Në vitin 1830, ai ndërmori një udhëtim që zgjati 17 muaj, nga Malta deri në Shqipëri. Në letrën e parë që i shkruan të atit, ai i drejtohet me këto fjalë:
"I dashur baba,
...Të përmenda në letrën time se mund të bëj një vizitë tek Veziri i Madh në Janinë, kryeqytetin e Shqipërisë."

Të jetë vizituar Shqipëria e atëhershme nga një kryeministër i ardhshëm britanik, sigurisht që sot shihet si një ngjarje e rëndësishme për kohën kur ndodhi, pavarësisht se në atë periudhë ai ishte thjesht një djalë që kërkonte aventura në vende ekzotike, larg Londrës së tij të zhurmshme. Benjamin Disraeli vizitoi Artën dhe Janinën, këtë të fundit duke e cilësuar si kryeqytetin e Shqipërisë. Letrat e tij dërguar babait janë plot me informacion për

Shqipërinë e asaj kohe. Në fakt, është interesante të theksohet se të gjithë udhëtarët britanikë që kanë udhëtuar në viset jugore të Shqipërisë, duke përfshirë Janinën, Prevezën dhe Artën, i referohen vendit tonë si Shqipëri dhe jo si një Provincë Osmane.

Por ajo që thotë Disraeli është shumë më e rëndësishme dhe përbën një referencë të vlefshme për historiografinë. Disraeli ishte Kryeministër i Britanisë së Madhe në kohën e Kongresit të Berlinit, një ngjarje historike, pasojat e së cilës janë të njohura mirë në historinë evropiane. Si një intelektual i klasit të parë, ai ka shkruar njëzet e tre libra. Janë të shumtë biografët që janë marrë me jetën dhe veprën e tij; ndër ta veçohet Douglas Hurd, Sekretar i Jashtëm i Britanisë së Madhe nga viti 1989 deri në vitin 1995.

Robert Blake e ka trajtuar atë me shumë hollësi. Në librin e tij, Blake na paraqet një pamje të pakëndshme të këtij britaniku të shquar me prejardhje hebraike, i prirur të mbështesë pushtuesit dhe jo të pushtuarit. Si një njeri që do të merrte frenat e një shteti perandorak, ai, në një moment të caktuar, kërkoi të rreshtohej në anën e forcave turke për të luftuar kundër shqiptarëve që ishin ngritur në kryengritje kundër Perandorisë Osmane, në fillim të viteve 1830. Po ashtu, ai shprehu antipati ndaj grekëve, të cilët kërkonin

shkëputjen nga sundimi osman. Tek ai mbizotëronte më tepër këndvështrimi perandorak sesa ai i krishterë, ndonëse vetë ishte një hebre i konvertuar në të krishterë që në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare.

Si një nga figurat qendrore të politikës britanike të shekullit të nëntëmbëdhjetë, është interesante të shihet me çfarë syri i ka vështruar ai shqiptarët. Po ashtu, është me shumë interes të vihet re se, vetëm dy vjet pas kthimit nga udhëtimi i tij në Shqipëri, ai shkroi një vepër për Skënderbeun me titullin *The Rise of Iskander*.

Kjo është një vepër letrare që ka në qendër figurën e Skënderbeut, por megjithatë, Disraeli nuk i jep atij identitetin historik të duhur, ndërsa ngjarjen e vendos në Athinë dhe Hungari. Disraeli është një nga figurat më polemizuese në historinë parlamentare britanike dhe njëkohësisht një ndër personalitetet me numrin më të madh të thënieve të cituara në historinë e politikës britanike. Një nga thëniet e tij më cinike, drejtuar rivalit të tij të përjetshëm, William Ewart Gladstone, gjithashtu Kryeministër i Britanisë së Madhe dhe lider i Partisë Liberale, ishte lojëria me inicialet e emrit të tij: GOM, që zyrtarisht nënkuptonte *Grand Old Man* – Plaku i Madh, por që Disraeli e ironizonte si *God's Only Mistake* – Gabimi i Vetëm i Zotit. Kjo shprehje mbeti si një nga kulmet e

debatit politik midis Kryeministrit dhe liderit të opozitës në parlamentin britanik.

Gjatë turit të tij në Shqipërinë e Jugut, Disraeli shoqërohet nga shqiptarë që e mbrojnë atë. Ai i përshkruan ata si më poshtë:

> *"Të gjithë këta shqiptarë janë të armatosur deri në dhëmbë, me kama, pistoleta dhe pushkë, të mbuluara krejtësisht me zbukurime të pasura dhe, herë pas here, tërësisht të lyera me argjend deri te qyta."*

Duhet pranuar se, për shkak të mentalitetit të politikës perandorake viktoriane, madje edhe një "benjamin" i saj – pikërisht ky politikan britanik – mund të kishte pasur mundësinë të ndihmonte Shqipërinë në Kongresin e Berlinit, por nuk tregoi asnjë vullnet për ta bërë këtë. Ai pranoi të mos e kundërshtonte Traktatin e Shën Stefanit, i cili kishte shkëputur pjesë të rëndësishme nga trungu territorial shqiptar.
Arsyet?

Letra që shqiptarët i dërguan Benjamin Disraelit, e përfshirë në këtë libër, mund të merret si një shembull konkret i kësaj situate. Megjithatë, duhet theksuar se, pa kontributin e tij, lakmitë e fqinjëve për një copëtim edhe më të madh të

trojeve shqiptare mund të kishin sjellë humbje territoriale edhe më të rënda sesa ato që realisht ndodhën.

[1] Me këtë autor kam patur rastin të bisedoj për librin e tij që sapo e kisha lexuar si dhe për Dizraelin dhe Shqipërinë. Dauglas Hurd ka luajtur një rol të rëndësishëm në rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri – Mbretëri e Bashkuar. Në një rast tjetër, gjatë takimit të Ministres tonë të Integrimit me z. David Lidington, Ministër i Zgjerimit Europian në Foreign Office, patëm rastin të flisnim për Dizraelin. Ai mbante në zyrën e tij portretin e Benjamin Dizraelit. Kur mbaruam takimin e pyeta:
– A është Dizraeli idhulli juaj politik?
– Po, më tha, – është, dhe shtoi: Nuk ka politikan më të sofistikuar se ai.
Kjo na dha mundësinë të hapnim një bisedë të gjatë për lidhjet e Disraelit me Shqipërinë.
[2] Robert Blake, Dizraeli, faqe 60, 64-65, 579.
[3] Rise of Iskander – Benjamin Disraeli – University of Adelajde – botuar për herë të parë në vitin 1834.


Benjamin Disraeli
Naltësimi i Iskanderit
Një studim i plotë dhe vepra e përkthyer nga
Mal Berisha
KOHA